

RAPORT

PËR PROCESIN E REKRUTIMIT DHE PROVIMIT TË KANDIDATËVE PËR
PROKURORË TË SHTETIT



KËSHILLI
PROKURORIAL
I KOSOVËS

Prishtinë, Mars 2022

Përmbajtja

I. HYRJE.....	2
II. KONKURSI.....	2
III. BAZA LIGJORE	3
IV. VEPRIMET DHE VENDIMET PARAPRAKE	4
V. PERZGJEDHJA PRELIMINARE.....	5
Qëllimet dhe Objektivat e secilës pjesë të Provimit.....	6
Pjesa 1, (Testi Kualifikues).....	6
Pjesa 2, (Testi me shkrim)	6
Pjesa 3, (Intervista me gojë).....	6
VII. HARTIMI I PROVIMIT PËR PROKUROR.....	6
VIII. FORMATIZIMI, SHTYPJA DHE RUAJTJA E PROVIMIT	8
Formatizimi i provimit	8
Fotokopjimi i materialeve të provimit.....	8
Rujtja e fshehtësisë dhe siguria	9
IX. PUBLICITETI DHE TRANSMETIMI I TË DHËNAVE TEK KANDIDATËT.....	9
X. ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI I TESTIT KUALIFIKUES.....	9
XI. VLERESIMI I TESTIT KUALIFIKUES	13
XII. TESTI ME SHKRIM.....	14
XIII. VLERESIMI I TESTIT ME SHKRIM	16
XIV. SHPALLJA E REZULTATEVE TE TESTIT ME SHKRIM	17
XV. PROCESI I VLERËSIMIT TË INTEGRITETIT PERSONAL DHE AFTËSIVE PROFESIONALE TË KANDIDATËVE.....	18
XVI. INTERVISTA.....	19
XVII. REZULTATET PRELIMINARE.....	20
XVIII. KOMISIONI PER RISHQYRTIM	20
XIX. PROPOZIMI I LISTËS SË KANDIDATËVE NË KËSHILLIN PROKURORIAL TË KOSOVËS.....	20
XX. REZULTATET PËRFUNDIMTARE TË PROVIMIT	21
XXI. MASAT E VEÇANTA TË NDËRMARRA PËR TË ARRITUR STANDARDET NDËRKOMBËTARE	21
XXII. FALËNDERIM PËR MBËSHTETJE.....	22
XXIII. KOMENTET E MONITORUESVE NDËRKOMBËTARË.....	23
XXIV. PËRFUNDIM	23

I. HYRJE

Neni 110 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK), si institucion plotësisht të pavarur në kryerjen e funksioneve të tij dhe me mandat për rekrutimin, propozimin, avancimin, transferimin dhe disiplinimin e prokurorëve në mënyrën e rregulluar me ligj.

Me Rregulloren nr. 07/2015 për procesin e rekrutimit, emërimit dhe riemërimit të Prokurorëve të Shtetit, të miratuar nga KPK-ja më 01 dhjetor 2015, janë përcaktuar kriteret dhe procedurat për organizimin e provimit dhe procesit të rekrutimit të kandidatëve për Prokurorë të Shtetit.

Mbështetur në mandatin ligjor, KPK ka organizuar provimin dhe ka zhvilluar procesin e rekrutimit të Prokurorëve të Shtetit.

Raporti pasqyron në mënyrë të detajuar procesin e hartimit, administrimit dhe vlerësimit të Provimit përfshirë dhe procesin deri në rekrutim të Prokurorëve të Shtetit.

Si qëllime kryesore të këtij raporti janë:

- Paraqitja në mënyrë publike dhe transparente e punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës, përkatësisht Komisionit për Rekrutim dhe Komisionit për Rishqyrtim në procesin e rekrutimit të Prokurorëve të Shtetit;
- Shpjegimi i progresit të arritur gjatë procesit të administrimit të Provimit për kandidatet për Prokurorë të Shtetit;
- Njoftimi me historikun e shkurtër të zhvillimit të Provimit për Prokuror të Shtetit dhe sfidat organizative;
- Publikimi i vendimeve/veprimeve që i paraprinë implementimit të Provimit për Prokurorë të Shtetit;
- Paraqitja e fazave të zbatimit të Provimit për Prokuror të Shtetit;
- Prezantimi i masave të veçanta që u ndërmoren nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, për të arritur standardet ndërkombëtare në organizim të këtij provimi;

II. KONKURSI

Këshilli Prokurorial i Kosovës me datë 22 maj 2020 mori vendim për shpalljen e tetë (8) pozitave të lira për Prokurorë të Shtetit.

Konkursi u hap me datë 01 qershor 2020 dhe vazhdoi deri me 15 qershor 2020. Gjithsejtë aplikuan dyqindedyzetegjashtë (246) aplikues për pozitën e Prokurorit të Shtetit, prej tyre nëntëdhjetenjë (91) femra dhe njëqindpesëdhjetepesë (155) meshkuj, ndërsa tre (3) nga aplikuesit ishin nga komuniteti joshumicë.

Ndërsa KPK me datën 27 prill 2021 për shkak të pandemisë mori vendim për rishpalljen e gjashtëmbëdhjetë (16) pozitive të lira për Prokurorë të Shtetit si në vijim:

1	Prokuroria Themelore Prishtinë	4
2	Prokuroria Themelore Ferizaj	3
3	Prokuroria Themelore Gjilan	2
4	Prokuroria Themelore Pejë	2
5	Prokuroria Themelore Gjakovë	4
6	Prokuroria Themelore Mitrovicë	1

Konkursi u hap me datën 11 maj 2021 dhe vazhdoi deri me 25 maj 2021, duke njoftuar të gjithë kandidatët të cilët kishin plotësuar kriteret ligjore gjatë procesit të aplikimit të vitit 2020, se nuk kanë nevojë të aplikojnë përsëri.

Gjithsejtë aplikuan njëqindshatëdhjetë (170) aplikues për pozitën e Prokurorit të Shtetit, prej tyre tetëdhjetetë (83) femra dhe tetëdhjeteshtatë (87) meshkuj, ndërsa vetëm një nga komuniteti joshumicë.

Andaj nga të dy konkurset, gjithsejtë aplikuan katërqindegjashtëmbëdhjetë (416) kandidatë për pozitën e Prokurorit të Shtetit.

Procesi i aplikimit edhe këtë herë u realizua online, duke u mundësuar të gjithë të interesuarave qasje në sistemin elektronik për aplikim.

III. BAZA LIGJORE

Në bazë të nenit 7 paragrafi 1 pika 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, parashihet që KPK-ja vendos për organizimin e provimit për kandidatët për prokurorë, sipas rregullores së miratuar nga Këshilli.

Këshilli Prokurorial i Kosovës me datë 01 dhjetor 2015 ka miratuar Rregulloren nr. 07/2015 për Rekrutimin, provimin, emërimin dhe riemërimin e Prokurorëve të Shtetit

me anë të së cilës përcaktohen rregullat dhe procedurat për procesin e rekrutimit të Prokurorëve të Shtetit.

IV. VEPRIMET DHE VENDIMET PARAPRAKE

Në bazë të nenit 16 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës mund të themelojë edhe komisione të tjera të përkohshme ose të përhershme sipas nevojës.

Në pajtim me Rregulloren nr. 07/2015 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e prokurorëve të shtetit, Këshilli Prokurorial i Kosovës më datë 27 prill 2021 ka miratuar përbërjen e Komisionit për Rekrutim, anëtarëve rezervë të këtij Komisioni si dhe përbërjen e Komisionit për Rishqyrtim dhe anëtarëve rezervë si në vijim:

Komisioni për Rekrutim ka këtë përbërje:

- z. Aleksander Lumezi, Kryeprokuror i Shtetit/Kryetar i Komisionit për Rekrutim;
- z. Lulzim Sylejmani, anëtar;
- znj. Arijana Shajkovci, anëtare;
- z. Xhevdet Bislimi, anëtar;
- z. Kujtim Munishi, anëtar.

Anëtar rezervë:

- z. Idain Smailji, dhe
- z. Enver Sokoli

Komisioni për Rishqyrtim ka këtë përbërje:

- z. Jetish Maloku, Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Kryetar i Komisionit;
- z. Agron Qalaj, anëtar dhe
- znj. Bedrije Sylja Alshiqi, anëtare

Anëtarë rezervë:

- znj. Sevdije Morina dhe
- z. Haxhi Dërguti

Në pajtim me nenin 7 të Rregullores nr. 07/2015, Këshilli Prokurorial i Kosovës më datë 27 prill 2021 mori vendim për caktimin e znj. Ismije Maxhuni, Administrator i Rekrutimit dhe Provimit që të kryej të gjitha veprimet e nevojshme administrative, në mënyrë që puna e Komisionit për Rekrutim të jetë funksionale.

V. PERZGJEDHJA PRELIMINARE

Komisioni për Rekrutim pas përfundimit të konkursit të datës 22 maj 2020, ka bërë edhe përzgjedhjen preliminare të aplikacioneve, të cilët i plotësonin kriteret e përcaktuara në konkurs.

Nga dyqindedyzetegjastë (246) aplikues, duke përfshirë edhe fazën e ankesave, këtë fazë e kaluan vetëm dyqindedhjetë (210) prej tyre.

Për shkak të pandemisë dhe masave në fuqi, KPK-ja me vendimin nr. 247/2021 ka rishpallur konkursin duke njoftuar të gjithë kandidatë të cilët kishin kaluar fazën preliminare dhe ishin në listën e publikuar në dhjetor 2020, se nuk kanë nevojë të aplikojnë përsëri.

Gjithashtu, Komisioni për Rekrutim pas përfundimit të konkursit të datës 27 prill 2021, bëri përzgjedhjen preliminare të aplikacioneve të cilët i plotësonin kriteret e përcaktuara në konkurs.

Nga njëqindeshtatëdhjetë (170) aplikues të cilët kishin aplikuar me rishpalljen e konkursit, duke përfshirë edhe fazën e ankesave, vetëm njëqindesdhjetë (152) e kaluan fazën preliminare.

Pas përfundimit të fazës së ankesave, Komisioni për Rekrutim publikoi listën finale sipas së cilës Testit Kualifikues do ti nënshtroheshin treqindegjastëdhjetë (362) kandidatë.

VI. STRUKTURA E PROVIMIT PËR PROKUROR

Komisioni për Rekrutim sipas Rregullores 07/2015 u pajtua që të hartohen, administrohen dhe vlerësohen tri lloje të provimeve bazuar në kategoritë si më poshtë:

1. Testi kualifikues;
2. Testi me shkrim, dhe
3. Intervista me gojë.

Qëllimet dhe Objektivat e secilës pjesë të Provimit

Pjesa 1, (Testi Kualifikues)

Kjo pjesë e provimit ishte dizajnuar për të vlerësuar aftësitë e përgjithshme të kandidatëve nga fusha penale, etika profesionale dhe të drejtat e njeriut dhe kishte gjithsejtë 60 pyetje me përgjigje alternative. Për tu kualifikuar kandidatët duhej të kishin së paku 45 pikë, përndryshe nuk do të kualifikoheshin.

Pjesa 2, (Testi me shkrim)

Kjo pjesë e provimit është krijuar për të bërë vlerësimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive të kandidatëve për analizimin e problemeve ligjore nga fusha e të drejtave të njeriut, kushtetuese, penale (materiale dhe procedurale) dhe drejtësia për të mitur.

Provimi me shkrim kishte gjithsejtë 60 pikë. Provimi përbëhej nga dy raste, secili prej tyre kishte nga 30 pikë dhe konsiderohej se kandidati për të kaluar këtë fazë, duhet të marr së paku 40 pikë.

Pjesa 3, (Intervista me gojë)

Intervista me gojë përmbante pyetjet përmes të cilave vlerësohej aftësia dhe shkathtësia e komunikimit si dhe personaliteti i tyre.

VII. HARTIMI I PROVIMIT PËR PROKUROR

Tryeza e punës për hartimin e Provimit për kandidatët për Prokuror të Shtetit është mbajtur nga data 13-16 korrik 2021.

Përveç anëtarëve të Komisionit për Rekrutim dhe Komisionit për Rishqyrtim në tryezën për hartimin e Provimit për kandidatët për Prokurorë të Shtetit morën pjesë edhe prokurorë dhe staf mbështetës të sistemit prokurorial.

Në këtë tryezë pune, UD. Drejtori i NJSHPP-së njëherësh Administratori i Provimit, znj. Ismije Maxhuni, prezantoi para anëtarëve të Komisionit qëllimin, rëndësinë dhe metodologjinë e hartimit të testeve të provimit, duke ju dhënë udhëzimet e nevojshme rreth detyrave të anëtarëve të Komisionit.

Para se të fillonte hartimi i provimit anëtarët e Komisionit dhe i gjithë stafi tjetër pjesëmarrës kanë nënshkruar një Deklaratë mbi Konfidencialitetin me të cilën morën obligimin që të ruajnë sekretin lidhur me përmbajtjen e provimit dhe në asnjë formë të mos e publikojnë atë.



Pjesëmarrësit e ndarë në grupe

Në këtë tryezë, anëtarët e Komisionit kanë punuar të ndarë në tri grupe punuese, në mënyrë të pavarur dhe në konfidencialitet të plotë edhe fizikisht larg nga njëri tjetri. Ata kanë hartuar pyetjet bazuar në ligjet e zbatueshme. Secili grup ka hartuar pyetjet në numër të njëjtë për secilën pjesë të provimit, pa e ditur përmbajtjen e punës së grupit tjetër.

Për tri versionet e provimit të hartuar për kandidatët, Komisioni identifikoi bazën ligjore dhe përgjigjen e saktë për secilën pyetje.

Qëllimi i hartimit të më shumë se një versioni të provimit ishte që të ruhet sekretin në mënyrë që askush (përfshirë komisionin dhe përkthyesit) të mos jetë në dijeni se cili version i provimit do të përdoret nga kandidatët në provim.

Çdo pjesë e provimit dhe në fund të gjitha provimet e hartuara nga grupet punuese janë rishikuar për ndonjë pasaktësi eventuale apo gabime gramatikore në formulim dhe çdo pyetje që është konsideruar e paqartë, është diskutuar me grupin hartues dhe është evituar çdo paqartësi.

Përkthimi në gjuhën serbe i provimeve të hartuara, është bërë menjëherë nga vetëm një përkthyes i KPK-së. Përkthyesi ka qenë vazhdimisht i monitoruar nga Administratori i provimit dhe nuk iu është lejuar lidhja e kompjuterëve me internet dhe komunikimi me telefon.

Në fund të çdo dite pune pyetjet e hartuara, të rishikuara dhe të përkthyer janë vendosur në USB dhe janë fshirë nga të gjithë kompjuterët.

Në përfundim të hartimit të provimit të gjitha materialet që gjendeshin në kompjuterë janë vendosur vetëm në USB të cilën e ka ruajtur Kryetari i Komisionit.

Kompjuterët ku është punuar provimi nuk kanë pasur lidhje interneti dhe komunikimi me telefon gjatë kohës së hartimit të provimit ka qenë i ndaluar.

VIII. FORMATIZIMI, SHTYPJA DHE RUAJTJA E PROVIMIT

Formatizimi i provimit

E gjithë puna tjetër rreth finalizimit dhe përgatitjes së provimit është zhvilluar në ndërtesën e Këshillit Prokurorial të Kosovës, ku u siguroa infrastruktura e nevojshme duke filluar nga zyra për fotokopjim, aparati fotokopjues, letër, ngjyrë dhe gjithë infrastrukturën tjetër të nevojshme.

Fotokopjimi i materialeve të provimit

Procesi i fotokopjimit është kryer në ndërtesën e KPK-së nga Administratori i provimit dhe një zyrtar i KPK-së, duke u siguruar që janë paketuar të gjitha kopjet e nevojshme brenda dhe se nuk ka ndonjë material tjetër në pako.

Çdo letër e dëmtuar gjatë fotokopjimit apo ndonjë letër e kopjuar dobët është shkatërruar menjëherë.



Fotokopjimi i materialeve dhe kopjeve të nevojshme

Ruajtja dhe sigurimi i provimit ka qenë nën përgjegjësinë e Administratorit të Provimit, ku edhe kanë qëndruar deri në momentin e transportimit në vendin ku është mbajtur provimi.

Ruajtja e fshehtësisë dhe siguria

Ruajtja e fshehtësisë lidhur me pyetjet dhe përgjigjet e provimeve është konsideruar si çështje me prioritet të lartë për KPK-në dhe Komisionin për Rekrutim. Janë aplikuar rregulla dhe procedura të rrepta për t'u siguruar që asnjë e dhënë lidhur me pyetjet apo përgjigjet e provimit të mos i bëhet e ditur askujt, siç përcaktohet me Rregulloren Nr. 07/2015 për Rekrutimin, provimin, emërimin dhe riemërimin e prokurorëve të shtetit. Është bërë kjo për t'u siguruar që asnjëri prej kandidatëve të mos ketë përparësi ndaj kandidatëve tjerë për shkak të çfarëdo përhapje paraprake të të dhënave lidhur me pyetjet e provimit.

Secili pjesëmarrës në procesin e hartimit dhe përgatitjes së provimit ka nënshkruar marrëveshjen mbi ruajtjen e fshehtësisë, duke u zotuar për mos zbulimin e asnjë të dhëne lidhur me pyetjet dhe përgjigjet e provimit dhe duke iu përmbajtur tërësisht rregullave dhe procedurave të sigurisë.

Puna tjetër rreth vazhdimin të përkthimit, formatizimit, kopjimit dhe mbylljes është kompletuar në ndërtesën e KPK-së ku ka qenë e ndaluar hyrja për persona tjerë përveç zyrtarëve përgjegjës dhe Administratorit të provimit. Kompjuterët e përdorur gjatë përgatitjes së provimit janë konfiguruar pa kyçje në internet dhe janë rregulluar në atë mënyrë që mos të kenë mundësi të shtypin apo kopjojnë cilëndo nga materialet e provimit.

Pjesëmarrësve të hartimit të provimit dhe stafit mbështetës nuk iu është lejuar që t'i marrin me vete apo të fusin brenda ndonjë USB/flash, fletë ose gjëra tjera në vendin e përgatitjes së provimit. I gjithë materiali në letër që është krijuar gjatë hartimit dhe përgatitjes së provimit, është shkatërruar.

IX. PUBLICITETI DHE TRANSMETIMI I TË DHËNAVE TEK KANDIDATËT

Kandidatët të cilët kanë plotësuar kushtet për t'iu nënshtruar testit kualifikues janë njoftuar me rregullat e provimit, procedurën e provimit, vendin dhe datën e provimit si dhe detajet tjera, nëpërmjet faqeve zyrtare të KPK-së dhe PSH-së si dhe janë njoftuar individualisht me e-mail.

X. ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI I TESTIT KUALIFIKUES

Pas rritjes së numrit të rasteve me COVID-19 dhe vendosjes së masave të reja kufizuese me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Testit kualifikues u

mbajt me datë 21 nëntor 2021 në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) në Vushtrri.

Duke pasur parasysh gjendjen me Covid 19 dhe Vendimin e Qeverisë lidhur me masat anticovid, pas kërkesës drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë, na është lejuar mbajtja e Testit kualifikues duke na obliguar që në mënyrë rigoroze ta zbatojmë këtë vendim.

Nga secili kandidat është kërkuar që të posedoj njërën nga dëshmitë si në vijim:

- 2.1. Certifikatën e vaksinimit për vaksinimin e plote ose marrjen e një doze të vaksinës kundër COVID-19;
- 2.2. Testi RT-PCR negativ për COVID-19, jo më i vjetër se 72 orë;
- 2.3. Dëshmi se personi ka kaluar COVID-19 (test RT-PCR pozitiv i lëshuar jo më pak se 21 ditë dhe jo më shumë se 180 ditë ose rezultat pozitiv i testit të antitropave serologjik - IgG, i lëshuar më së shumti para 30 ditëve;
- 2.4. Testi shpejtë antigjen negativ jo më i vjetër se 48 orë.

Nga treqindegjashtëdhjetedy (362) kandidatët të cilët kishin plotësuar kriteret ti nënshtroheshin testit kualifikues, vetëm dyqindeshtatëdhjeteshtatë (277) kandidatë morën pjesë, pasi që të tjerët ndërkohë ishin tërhequr nga procesi.

Nga ky numër i kandidatëve tre (3) ishin nga komuniteti jo shumicë.

Regjistrimi i kandidatëve për t'iu nënshtuar testit kualifikues është bërë nga stafi i KPK-së. Për shkak të numrit të madh të kandidatëve janë përdorur tri salla.



Procesi i regjistrimit

Kandidatët janë ndarë nëpër salla sipas shenjave dalluese të koduara me ngjyrë të cilat janë tërhequr nga vet kandidatët para fillimit të testit kualifikues. Përjashtimi i vetëm ishte për kandidatët që kanë zgjedhur të testohen në gjuhën serbe, ku ata janë udhëzuar të shkojnë në të njëjtën sallë dhe në këtë mënyrë është nevojitur vetëm një përkthyes i gjuhës serbe për të lexuar udhëzimet e testimit në fillim dhe në fund të periudhës së paraparë për testim.



Monitoruesit/vëzhguesit ndërkombëtar dhe vendorë

Përveç administratorit të provimit në sallë kanë qëndruar edhe monitoruesit ndërkombëtarë dhe ata vendorë, ndërsa stafi i KPK-së ka ndihmuar në shpërndarjen dhe mbledhjen e provimeve.

Kandidatët janë njoftuar paraprakisht se janë të obliguar të marrin me vete dokumentin e identifikimit dhe nuk do të ju lejohet asnjë lloj dokumentacioni tjetër, përfshirë telefon, llap top, çantë dore, laps, dosje apo letër, etj. ashtu edhe siç është përcaktuar me Rregullore.

Para se të fillonte provimi një kandidat vullnetar ka zgjedhur me short njërin nga tre versionet/grupet e provimit të testit kualifikues i cili do të përdorej në provim.



Tërheqja e shortit nga kandidati vullnetar

Provimi është mbajtur nën drejtimin e përgjithshëm dhe mbikëqyrjen e UD. Drejtorit të NJSHP-së të cilin KPK-ja e ka caktuar Administrator të provimit dhe ka pasur autoritetin për vendimmarrje përfundimtare në rast të ndonjë shkelje apo kundërshtimi të rregullave, procedurave apo udhëzimeve të testit si dhe stafit të KPK-së.

Provimi është monitoruar nga përfaqësues ndërkombëtarë dhe vendor të OSBE-së, EULEX-it, Grupit për Studime Politike dhe Juridike-GLPS, ndërsa janë vëzhguar nga përfaqësues të EUKOJUST dhe Projektit të Ambasadës Britanike Axiom International, ndërsa siguria ishte bërë nga personeli i AKSP.

Për të shikuar me afër rrjedhën e provimit, i pranishëm ishte edhe Kryeprokurori i Shtetit z. Aleksandër Lumezi, njëherësh Kryetar i Komisionit për Rekrutim, Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës z. Jetish Maloku, Kryetar i Komisionit për Rishqyrtim, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë z. Kujtim Munishi, anëtar i Komisionit për Rekrutim si dhe Prokurori i Shtetit z. Lulzim Sylejmani, anëtarë i Komisionit për Rekrutim.



Kryeprokurori i Shtetit, Kryesuesi i KPK-së dhe Komisioni gjatë monitorimit të Testit Kualifikues

Secili kandidat është ulur në një tavolinë për një person duke respektuar masat anticovid dhe tavolinat kanë pasur hapësirë të mjaftueshme për monitoruesit e sallave që të kalojnë në mes tyre si vertikalisht ashtu edhe horizontalisht.



Salla I



Salla II



Salla III

Përveç zarfit në të cilën ishte vendosur pjesa e provimit, kandidatëve iu është shpërndarë edhe një zarf i vogël brenda të cilit ishte një pjesë letër e zbrazët dhe e vulosur ku kandidatët duhej të shënonin emrin dhe mbiemrin.

Pasi ka përfunduar provimi Administratori i provimit ka shkuar tek secili kandidat dhe i ka marrë të dy zarfat dhe ka shkruar një numër të njëjtë në secilin zarf. Këtë numër nuk e ka regjistruar askush. Pastaj të dy zarfat janë vendosur në një kuti e cila është mbyllur, vulosur dhe nënshkruar nga Administratori i Provimit. Kutitë ishin të siguruara nga Administratori derisa iu janë dorëzuar Komisionit për ti vlerësuar.

Numrat e zarfeve nuk iu kanë bërë të ditur as kandidatëve e as anëtarëve të Komisionit me qëllim që të mbrohej konfidencialiteti i procesit. Asnjë kandidat nuk ishte përjashtuar për shkak të mosrespektimit të rregullave dhe asnjë prej tyre nuk e ka kundërshtuar administrimin e provimit.

Udhëzimet hyrëse dhe përmbyllëse janë lexuar nga ana e Administratorit të provimit në gjuhën shqipe dhe nga përkthyesit janë përkthyer në gjuhën serbe.



Monitoruesit vendorë, ndërkombëtarë dhe stafi mbështetës pas përfundimit të Testit Kualifikues

XI. VLERESIMI I TESTIT KUALIFIKUES

Komisioni për Rekrutim më datë 22 deri me 25 nëntor 2021 në hapësira të veçanta të KPK-së dhe me qasje vetëm për personat e autorizuar, pandërprerë dhe në mënyrë shumë profesionale ka vlerësuar testin kualifikues.

Në fillim Komisioni verifikoi edhe një herë pyetjet dhe përgjigjet e sakta për të cilat u përpiluan çelësat për përgjigjet e sakta.



Komisioni për Rekrutim dhe vëzhguesit gjatë hapjes së provimit, verifikimit të pyetjeve dhe vlerësimit të Testit Kualifikues

Administratori i provimit, para Komisionit hapi vetëm zarfet e mëdhenj, në të cilët gjendeshin provimet e kandidatëve. Pastaj Komisioni, ka vlerësuar provimet vetëm sipas numrit të provimit në zarf. Në momentin e hapjes së zarfeve secilit test brenda iu dha numri i njejtë me zarfin.

Komisioni ka punuar i ndarë në grupe dhe kanë bërë vlerësimin duke përdorur çelësat e përgjigjeve të sakta të punuara në momentin e hartimit të provimit.

Nga 277 kandidatët të cilët i ishin nënshtruar testit kualifikues vetëm 177 prej tyre kaluan, ndërsa 100 të tjerët nuk e kaluan këtë test.

Në pajtim me Rregulloren 07/2015 më datë 30 nëntor 2021 u publikua lista e kandidatëve të cilët e kaluan testin kualifikues si dhe lista e kandidatëve të cilët nuk e kaluan testin kualifikues.

Kandidatët të cilët nuk kaluan testin kualifikues u njoftuan se kishin të drejtë të shikojnë testet e tyre si dhe të parashtrojnë ankesë tek Komisioni për Rishqyrtim deri më 03 dhjetor 2021.

Qasjen në Testin kualifikues e shfrytëzuan nëntëmbëdhjetë (19) kandidatë, ndërsa brenda afatit të pacaktuar ligjor u pranuan tetëmbëdhjetë (18) ankesa.

Komisioni për Rishqyrtim në takimin e datës 07 dhjetor 2021, shqyrtoi ankesat dhe vendosi që tetë (8) ankesa të aprovohen.

XII. TESTI ME SHKRIM

Testi me shkrim u mbajt me datë 19 dhjetor 2021 në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtri.

Të pranishëm ishin monitoruesit ndërkombëtar dhe vendorë të cilët në vazhdimësi përcollën mbarëvajtjen e testit, si dhe anëtarë të Komisionit për Rekrutim.

Edhe në testin me shkrim nga secili kandidat është kërkuar që të posedoj njëren nga dëshmitë si në vijim:

- 2.1. Certifikatën e vaksinimit për vaksinimin e plotë ose marrjen e një doze të vaksinës kundër COVID-19;
- 2.2. Testi RT-PCR negativ për COVID-19, jo më i vjetër se 72 orë;
- 2.3. Dëshmi se personi ka kaluar COVID-19 (test RT-PCR pozitiv i lëshuar jo më pak se 21 ditë dhe jo më shumë se 180 ditë ose rezultat pozitiv i testit të antitropave serologjik - IgG, i lëshuar më së shumti para 30 ditëve;
- 2.4. Testi shpejtë antigjen negativ jo më i vjetër se 48 orë.

Regjistrimi i kandidatëve për t'iu nënshtruar provimit është bërë nga stafi mbështetës i KPK-së dhe ky regjistrim filloi nga ora 07:30 deri në ora 08:30 ndërsa testi filloi në ora 09:00.

Njëri nga kandidatët vullnetar zgjodhi me short njërin nga dy grupet e testit i cili është përdorur gjatë provimit.

Testit ju nënshtruan njëqindetëdhjetë (100) kandidatë pasi që pesë (5) ishin tërhequr në ndërkohë. Të gjithë kandidatëve iu siguria nga një përmbledhje e ligjeve penale materiale dhe procedurale.



Kandidatët gjatë Testit me Shkrim

Pjesa e parë e testit filloi në ora 09:00 dhe përfundoi në ora 12:00. Kandidatët vendosën pjesën e parë të provimit nëpër zarfe të cilat i mbyllën dhe shkuan në pauzën e drekës.

Atyre nuk iu është lejuar të dalin jashtë qendrës së AKSP-së, apo të komunikojnë me këdo jashtë qendrës. Para se të dilnin, kandidatët mbi tavolinën e punës kanë vendosur dokumentin identifikues në mënyrë që të ulen në vende të njëjta në pjesën e dytë të testit me shkrim.

Pas pauzës së drekës, kandidatët në ora 13:00 u rikthyen në sallë dhe filloi pjesa e dytë e testit e cila përfundoi në ora 16:00.

Kandidatët pas përfundimit të pjesës së dytë të provimit sipas instruksioneve të marra në fillim të testit, e mbyllën zarfin dhe të dy pjesët e provimit të mbyllura në zarfa (pjesën e parë dhe pjesën e dytë) i vendosen dhe i mbyllën në një zarf të madh. Përveç zarfit në të cilën ishin vendosur dy pjesët e provimit kandidatëve iu është shpërndarë edhe një zarf i vogël brenda të cilit ishte një pjesë letër e zbrazët dhe e vulosur ku kandidatët duhej të shënonin emrin dhe mbiemrin dhe të njëjtën ta mbyllin personalisht.

Pas përfundimit të testit me shkrim, Administratori i provimit ka shkuar tek secili kandidat dhe i ka ngjitur zarfin e madh në të cilin ishin vendosur dy pjesët e testit me shkrim si dhe zarfin e vogël brenda se cilës ishte shënuar emri dhe mbiemri i kandidatit.

Pas largimit të kandidatëve, nën përcjellën e monitoruesve, Administratori i provimit ka vendosur në secilin zarf të madh dhe secilin zarf të vogël nga një numër sekret.

E gjithë procedura e regjistrimit, administrimit, monitorimit, mbikëqyrjes, sekretit të provimit dhe gjithë procesit të testit me shkrim, ka qenë e njëjtë me testin kualifikues të mbajtur me datë 21 nëntor 2021.

XIII. VLERESIMI I TESTIT ME SHKRIM

Nga data 20 deri më datë 25 dhjetor 2021, në ambientet e KPK-së, në hapësira të veçanta me qasje vetëm për personat e autorizuar, Komisioni për Rekrutim vlerësoi testin me shkrim.

Të pranishëm gjatë hapjes së pakos së provimit ishte Kryesuesi i KPK-së si dhe përfaqësues të Projektit të Ambasadës Britanike që monitoruan procesin e vlerësimit të testeve.



Komisioni për Rekrutim dhe monitoruesit gjatë hapjes dhe vlerësimit të Testit me Shkrim

Vlerësimi i Testit me shkrim u bë në pajtim me Rregulloren 07/2015. Administratori i provimit hapi para Komisionit vetëm zarfet e mëdhenj në të cilët gjendeshin testet me shkrim të kandidatëve. Pastaj Komisioni ka vlerësuar testet me shkrim vetëm sipas numrit të provimit në zarf.

Në momentin e hapjes së zarfeve gjithsecilit test me shkrim iu dha numri identifikues që ishte në zarf, në mënyrë që të mos mund të ngatërroheshin ato me testet tjera. Zarfat e vegjël të cilat përmbanin emrin e kandidatëve u ndanë dhe u vendosën në një pako të veçantë.



Vendosja e numrit identifikues në testin me shkrim
(foto e marre nga raportit i vitit 2017)

XIV. SHPALLJA E REZULTATEVE TE TESTIT ME SHKRIM

Nga njëqindetëdhjetë (180) kandidatët të cilët iu nënshtruan testit me shkrim, vetëm gjashtë (6) prej tyre kaluan këtë pjesë të provimit ndërsa të tjerët nuk arritën të grumbullojnë minimumin e nevojshëm të pikëve që ishte 40 pikë ashtu siç e parasheh Rregullorja 07/2015.

Pikët e provimit u verifikuan dhe u kontrolluan edhe një herë dhe u krijua një listë vetëm me numrat e provimit. Bazuar në këtë listë u identifikuan gjashtë (6) kandidatët të cilët kaluan këtë pjesë të provimit.

Zarfet e vegjël u hapen nga Kryetari i Komisionit pas përfundimit të vlerësimit të përgjithshëm me datë 29 dhjetor 2021 në mënyrë që të bëhet renditja dhe shpallja e listës së kandidatëve të cilët e kishin kaluar provimin.

Shpallja e rezultateve preliminare u bë më datë 29 dhjetor 2021. Kandidatët u njoftuan individualisht se kanë të drejtë të parashtrorjnë ankesë tek Komisioni për Rishqyrtim i KPK-së brenda afatit të përcaktuar me Rregullore.

Brenda afatit të përcaktuar ligjor u pranuan njëqinddhjetë (110) ankesa.

Komisioni për Rishqyrtim pas shqyrtimit dhe vlerësimit të tyre, vendosi të refuzoj të gjitha ankesat e ankuesve, si dhe i njoftoi individualisht të gjithë parashtruesit e ankesave.



Vëzhguesit dhe Komisioni për Rishqyrtim gjatë vlerësimit të ankesave ndaj Testit me shkrim

Të gjithë ankuesit të cilët kishin kërkuar qasje në testin me shkrim, kjo ju mundësua dhe këtë të drejtë më 17 janar 2019 e shfrytëzuan dymbëdhjetë (12) prej tyre.

Në pajtim me nenin 25.6 të Rregullores, pas shqyrtimit të ankesave nga Komisioni për Rishqyrtim i Këshillit Prokurorial të Kosovës, më 13 janar 2022 u publikua lista përfundimtare e Testit me Shkrim.

XV. PROCESI I VLERËSIMIT TË INTEGRITETIT PERSONAL DHE AFTËSIVE PROFESIONALE TË KANDIDATËVE

Me datë 18 janar 2021, Komisioni për Rekrutim ka kërkuar nga të gjitha gjykatat përfshirë degët e tyre si dhe prokuroritë, verifikimin e listës së tetë (8) kandidatëve¹ dy (2) prej të cilëve në pajtim me nenin 37 pika 3 të Rregullores.

Përveç gjykatave dhe prokurorive verifikimi është kërkuar edhe nga: Policia e Kosovës, Agjencia Kosovare e Pronës, Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve, Administrata Tatimore e Kosovës, Dogana e Kosovës, Agjencia Kadastrale e Kosovës, Agjencia Kundër Korrupsionit, Oda e Avokatëve të Kosovës si dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Procedura e vlerësimit të integritetit personal dhe aftësive profesionale të kandidatëve ashtu siç e parasheh edhe Rregullorja, bëhet përmes verifikimit të informatave të

¹ Neni 37 pika 3 e Rregullores 07/2015 parasheh “Kandidatet të cilët kanë përfunduar provimin dhe trajnimin fillestar të organizuar nga IGJK do ti nënshtrohen vetëm intervistës me gojë dhe procesit të vlerësimit të integritetit personal dhe aftësive profesionale të kandidatëve, siç është përcaktuar me nenin 23 dhe 24 të Rregullores.

siguruara nga kandidati si dhe çfarëdo informacioni tjetër relevant që vendos të kërkoj Komisioni për Rekrutim.

Informatat lidhur me përvojën e punës dhe performancën, publikimet dhe dokumentet profesionale e akademike, informacionet mbi masat eventuale disiplinore, sjelljet jashtë zyrës, historikun mbi të kaluarën penale etj. duhet të mblidhen në pajtim me dispozitat ligjore me të cilat mbrohen të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe me qëllim që të sigurohen informata relevante për të zbardhur personalitetin, përvojën profesionale si dhe personale të kandidatit.

Pas procesit të verifikimit, të gjithë kandidatët u njoftuan për datën dhe kohën e intervistës si dhe me të drejtën e përcaktuar me nenin 21.6 të Rregullores².

Këtë të drejtë e realizuan të gjithë kandidatët të cilët shprehën interesim ta shikojnë dosjen e tyre personale, si dhe dokumentacionin e mbledhur rreth të kaluarës së tyre personale dhe profesionale.

XVI. INTERVISTA

Intervistat u zhvilluan më 02 dhe 03 mars 2022. Të gjithë kandidatët u intervistuan duke ju parashtruar pyetjet standarde në mënyrë që Komisioni të nxjerrë informata që janë relevante me kriteret për emërim, siç parashihet në Ligjin për Prokurorin e Shtetit dhe Ligjin për KPK-në.

Intervista, vlerësimi i integritetit personal dhe aftësive profesionale sipas Rregullores, vlerësohet më së shumti 40 pikë prej të cilave më së shumti 15 pikë janë të parapara për vlerësimin e integritetit personal.



Komisioni për Rekrutim gjatë mbajtjes së intervistave

² Neni 21.6 i Rregullores 07/2015-Kandidatet kanë të drejtë të njoftohen dhe ti shikojnë dokumentet e mbledhura dhe draft dokumentacionin jo më herët se 10 dhe jo më vonë se 5 ditë para mbajtjes së intervistës me gojë.

Pas përfundimit të intervistimit për secilin kandidat, anëtarët e Komisionit plotësuan formularin e vlerësimit duke shënuar pikët për kandidatët në mënyrë individuale dhe nënshkruan vlerësimet e tyre.

Intervistat me gojë janë monitoruar nga përfaqësues të EULEX-it, GLPS-së si dhe janë vëzhguar nga përfaqësues të EUKOJUST.

XVII. REZULTATET PRELIMINARE

Komisioni për Rekrutim pas përfundimit të intervistës me gojë ka përgatitur dhe shpallur rezultatet preliminare në pajtim me Rregulloren.

Rezultateve të testit me shkrim i janë shtuar edhe rezultatet e intervistës me gojë dhe nga totali i këtyre rezultateve është bërë edhe rangimi i kandidatëve më të suksesshëm sipas nenit 24 pika 2 e Rregullores³.

Ndaj këtyre rezultateve kandidatët kanë pasur të drejtë të parashtrijnë ankesë pranë Komisionit për Rishqyrtim të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

XVIII. KOMISIONI PER RISHQYRTIM

Në pajtim me nenin 25 të Rregullores kandidatët kanë të drejtë të parashtrijnë ankesë brenda tre (3) ditëve nga dita e publikimit të rezultateve preliminare të provimit.

Brenda afatit të përcaktuar me Rregullore, Komisioni për Rishqyrtim i Këshillit Prokurorial të Kosovës nuk ka pranuar ankesë.

XIX. PROPOZIMI I LISTËS SË KANDIDATËVE NË KËSHILLIN PROKURORIAL TË KOSOVËS

Në pajtim me Rregulloren për Rekrutimin, Provimin, Emërim dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit, Komisioni për Rekrutim do të përgatis listën me propozimet e kandidatëve për Prokuror të Shtetit nëpër Prokuroritë Themelore të Republikës së Kosovës.

³ Neni 24.2 i Rregullores 07/2015 “Provimin konsiderohet se e kalojnë kandidatët të cilët kanë arritur rezultate më të larta dhe janë në kuadër të numrit të kandidateve të përcaktuar nga KPK-ja me konkurs me kusht që të kenë arritur së paku 60 pikë në provimin me shkrim, intervistën me gojë dhe vlerësimin e integritetit personal dhe aftësive profesionale”

Kjo listë do ti dorëzohet Këshillit Prokurorial të Kosovës në mbledhjen e radhës.

XX. REZULTATET PËRFUNDIMTARE TË PROVIMIT

Pas që Komisioni për Rishqyrtim nuk kishte ankesa për ti trajtuar, Këshilli Prokurorial i Kosovës në pajtim me Rregulloren, do të publikoj rezultatet përfundimtare të provimit.

XXI. MASAT E VEÇANTA TË NDËRMARRA PËR TË ARRITUR STANDARDET NDËRKOMBËTARE

Me qëllim të arritjes së standardeve më të larta për organizimin e provimit për prokurorë, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka ndërmarrë këto masa:

- ✓ Janë hartuar disa grupe provimesh, me qëllim të ketë përzgjedhje më të zgjeruar të pyetjeve dhe më pak mundësi që vet hartuesi, komisioni apo stafi i KPK-së të njohin përmbajtjen e pjesëve që do të përdoren në ditët e provimit.
- ✓ Testi kualifikues ka pasur tre grupe dhe Testi me shkrim ka pasur dy grupe ku kandidatëve në ditën e mbajtjes së testeve ju është mundësuar përzgjedhja e grupit të pyetjeve me short.
- ✓ Testi kualifikues përfshinte njohuritë e përgjithshme të kandidatëve lidhur me të drejtën penale (materiale dhe procedurale) përfshirë të drejtat e njeriut dhe etiken profesionale. Ndërsa testi me shkrim përfshinte njohuritë e kandidatëve rreth përshkrimit të gjendjes faktike dhe aplikimit të së drejtës materiale, procedurale, strukturës së vendimit, vlerësimit dhe analizimit të provave, argumentimit dhe logjikes për arsyetimin, të kuptuarit dhe mënyrës së të shkruarit me qëllim të vlerësimit më të gjithanshëm të kandidatëve.
- ✓ Anëtarët e Komisionit nuk kanë pasur dijeni se cilat grupe të provimeve do të përdoren nga kandidatët ditën e provimit të parë dhe të dytë.
- ✓ Fotokopjimi i testeve është bërë nga Administratorit i provimit dhe një zyrtar i KPK-së.
- ✓ Përkthimi i testeve është bërë në kompjuterë të veçantë të cilët nuk kanë qenë të lidhur në rrjet.

- ✓ Përkthyesit nuk iu është lejuar të përdor telefonin apo të kenë USB, ose pajisje tjetër që mund të regjistrojë apo transferojë materialet e provimit.
- ✓ Pasi që kandidatët kanë përfunduar provimin të gjitha testet janë vendosur në një zarf të madh (A3) e cila ka marrë një numër të cilin nuk e kanë e ditur as kandidatët e as anëtarët e komisionit.
- ✓ Zarfet e vegjël të mbyllur brenda të cilave në një copë letër të vulosur ka qenë i shënuar Emri dhe Mbiemri i kandidatit, kanë marrë numrin e njëjtë sikur zarfi i madh me teste, në momentin kur kandidatët e kanë dorëzuar testin tek administratori i provimit.
- ✓ Testet janë vlerësuar nga anëtarët e komisionit të KPK-së në mënyrë të paanshme, dhe konfidenciale pa njohur identitetin e kandidatëve.
- ✓ Testi Kualifikues dhe Testi me Shkrim është mbikëqyrë nga monitorues ndërkombëtarë si OSCE, EULEX-i, GLPS dhe është vëzhguar nga Axiom international dhe EUKOJUST.
- ✓ Intervistat me gojë janë monitoruar nga përfaqësues të EULEX-it, GLPS-së si dhe janë vëzhguar nga përfaqësues të EUKOJUST.
- ✓ Të gjitha materialet e nevojshme për realizimin e provimit janë siguruar nga KPK-ja dhe kandidatët nuk janë lejuar të sjellin asgjë me vete gjatë provimeve.

XXII. FALËNDERIM PËR MBËSHTETJE

Këshilli Prokurorial i Kosovës shpreh falënderim për përkrahjen e ofruar gjatë procesit të provimit nga institucionet vendore si dhe organizatat si më poshtë:

- Akademia e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri (ASKP);
- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE);
- EULEX;
- Axiom international;
- EUKOJUST;
- Akademia e Drejtësisë;

XXIII. KOMENTET E MONITORUESVE NDËRKOMBËTARË

Monitoruesit ndërkombëtarë kanë vlerësuar se përkundër situatës me pandeminë dhe numrit shumë të madhe të kandidatëve në proces, provimi është hartuar, organizuar dhe administruar në pajtueshmëri me standardet e pranuar ndërkombëtarisht.

XXIV. PËRFUNDIM

Përkundër shumë sfidave duke përfshirë edhe situatën me Covid 19, Komisioni për Rekrutim i Këshillit Prokurorial të Kosovës me sukses ka hartuar, administruar dhe vlerësuar provimin për prokurorë, për të gjithë kandidatët me profesionalizëm, paañesi, dhe transparencë përgjatë tërë procesit.

Rezultati i këtij procesi, është përgatitja e listës përfundimtare drejtuar KPK-së me emrat e kandidatëve të suksesshëm për të filluar detyrën si prokurorë, të cilët do të mbrojnë të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit.